

Rilind Dauti¹

UDC: 327(4):323.1(=163.3)"1878/1913"
327.56(4):2(497.7)

**FUQITË E MËDHA DHE ÇËSHTJA MAQEDONASE (1878-1913):
RELIGIOCENTRIZMI SI FAKTOR I KEQMENAXHIMIT POLITIK**

**ГОЛЕМИТЕ СИЛИ И МАКЕДОНСКОТО ПРАШАЊЕ (1878-
1913): РЕЛИГИОЦЕНТРИЗМОТ КАКО ФАКТОР ВО
ПОЛИТИЧКОТО ЛОШО УПРАВУВАЊЕ**

**THE GREAT POWERS AND THE MACEDONIAN QUESTION
(1878-1913): RELIGIOCENTRISM AS A FACTOR IN POLITICAL
MISMANAGEMENT**

Abstract

Long before the UN Security Council, a group of states that dealt with the management of conflict zones and international disputes was the Concert of Europe, composed of the most powerful states of the time. An issue which at the turn of the 20th century became part of their agenda was the Macedonian Question, where the interests of many parties were intertwined, starting from the Great Powers themselves, the Christian Balkan states, the Ottoman Empire, as well as the Macedonian population itself, which had become (in)famous in Europe for its extreme diversity.

Throughout the centuries, for most people in Macedonia, the primary identity was religious, being Muslim or Christian. But either due to the encouragement of other states, or from the initiatives of local figures, ethnicity began to gain relevance among the inhabitants of Macedonia, as well as ethnic nationalism as its most political reflection. This was especially the case among the Christian population, which neighboring Orthodox states made the target of their respective national propaganda. Initially, these were harmless frictions, but they gradually evolved into deadly violence caused by chetas of

¹ Kandidat për doktoratë në Universitetin e Evropës Juglindore, Shkup&Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut. Email: rilind_dauti@hotmail.com

Christians of various nationalities, backed by one of the three Orthodox Balkan states: Greece, Bulgaria, and Serbia.

But this nationally motivated violence was largely disregarded by the Great Powers, and efforts to manage the Macedonian Question were based almost entirely on the dichotomy “Muslims vs. Christians.” In the end, all suffered greatly from this miscalculation, which carries important lessons for contemporary efforts of resolution of disputes and conflicts.

Keywords: Macedonia, Great Powers, religion, national, conflict management

Hyrje

Feja paraqet një fjalë, porosi a ligj hyjnor, një mister mbresëlënës, *misterium fascinans* (Otto), një dukuri ku njeriu merr pjesë me gjithë qenien e tij (Freyer).² Religjioni nuk është institucion i ngathët që ngërthen vetëm besim e rituale fetare, por edhe një faktor i fuqishëm shoqëror që çon te krijimi, konsolidimi dhe mirëmbajtja e një bashkësie. “Përvojat religjioze të përbashkëta të grupit dhe ritualet vazhdimisht e riprodhojnë dhe e përcjellin te brezat e ardhshëm ndjenjën kolektive për atë se “kush jemi” dhe se “ç’kuptim ka të jesh njëri prej nesh”.³ Ai gjeneron besim të ndërsjellë, empati për vuajtjet e sivëllezërve në fe dhe solidaritet përmes ndihmës konkrete për njëri-tjetrin, frymon barazi, duke tejkaluar dallimet në status, klasë, racë apo etni.

Nga religjionet e mëdha planetare, një religjion që në tekstet e veta të shenja dhe qysh në fillimet e hershme e ka theksuar këtë barazi mes besimtarëve, është Islami.⁴ Një hadith që shpesh citohet në këtë drejtim, është ai që në mënyrë të drejtpërdrejtë thotë se nuk ka përparësi një arab mbi një joarab (dhe anasjelltas), apo një i bardhë mbi një të zi (dhe anasjelltas). Por një është parimi i përgjithshëm, apo ideali i synuar, dhe tjetër është realiteti në praktikë, sepse, edhe tek muslimanët si ndjekës të një feje që aq shumë e thekson barazinë dhe vëllazërinë, prapëseprapë janë të pranishme aspektet negative që vijnë nga dallimet racore, etnike, fisnore, etj. Madje, relativisht pak kohë pas vdekjes së Profetit Muhamed, kur shumë më shumë se sot duhej të ishin të freskëta kujtimet e haditheve që parashohin trajtim të barabartë pa dallim fisi, etnie, e ngjyre të lëkurës^{5, 6}, u ngjit në pushtet Kalifati Emevit që

² Pajaziti, A. (red.) (2023). *Sociologji e Islamit: Hrestomaci*. Shkup: Logos-A, Parathënia.

³ B. McGuire, M. (2007). *Religjioni: Konteksti shoqëror*, përkth. Ali Pajaziti. Shkup: Logos-A, 44.

⁴ Qadhi, Y. (13 korrik 2015). *Ramadan 2015 Quranic Gems (20): Islam Abolished Racism 1,400 Years Ago*. YouTube. <https://www.youtube.com/watch?v=hTeo59sUSng>

⁵ Elias, A. A. (17 korrik 2020). *Islam is against racism and prejudice*.

<https://www.abuaminaelias.com/islam-against-racism-bigotry/>

⁶ Elias, A. A. (1 qershor 2021). *Tribalism and racism is ignorance in Islam*.

<https://www.abuaminaelias.com/ignorance-tribalism-racism/>

bënte diskriminim të hapur të muslimanëve joarabë, gjë që ishte njëri nga shkaqet kryesore që çoi te përmbysja e emevitëve përmes revolucionit abasid.⁷ Pastaj, trupi i vetëm global musliman nisi të ndahet në principata, mikro-shtete e organizime politiko-territoriale më të vogla, që madje jo rrallë luftonin mes vete. Po ashtu, të hershme në historinë e Islamit janë edhe konfliktet e brendshme civile mes një grupacioni kundër një tjetri. Si p.sh. ithtarët e Muavijes kundër Aliut, ithtarët e Jezidit kundër Hasanit e Hysejnit, etj.

Pra, sado që feja në vetvete është faktor që e krijon një bashkësi, ndërsa në Islam është edhe koncepti i Ummetit si një lloj imperativi kuranor dhe profetik për unitetin dhe vëllazërinë mes muslimanëve, është pikërisht motivi për pushtet politik dhe dominim mbi të tjerët, ai që edhe në një fe si Islami me konceptin e Ummetit dhe një korpusi hadithesh që flasin për vëllazërinë dhe barazinë e të gjithë muslimanëve pa dallim fisi, etnie dhe race, ka çuar që në shumë raste të kenë mbijetuar tribalizmi, etnocentrizmi dhe racizmi. Ka qarqe muslimane që besojnë se në të kaluarën muslimanët ishin në një idile të unitetit global dhe këtë e paska prishur depërtimi në tokat muslimane i “sëmundjes” së nacionalizmit, por në realitet, ndarja mes muslimanëve dhe konfliktet religjioze, ideologjike dhe politike janë fenomen shumë më i hershëm se ato që i atribuohen nacionalizmit që ka shpërthyer në shekullin XIX.

Kjo hyrje synon që në mënyrë komparative të paraqesë përballjen mes idealit sublim të vëllazërisë mes besimtarëve të një feje, si edhe realitetit politik dhe motiveve tjera që e kanë penguar realizimin e këtij ideali. Përpos konflikteve brenda trupit islam që i përmendëm, janë të njohura edhe konfliktet ndërshtetërore dhe ato të brendshme civile brenda shteteve të krishtera. Por një tip konflikti që është edhe më i vështirë për t’u paramenduar, është konflikti civil në mes krishterëve përderisa ishin nën sovranitetin e një shteti jokrishter!

Natyra e Çështjes Maqedonase

Te rasti i Çështjes Maqedonase në periudhën e venitjes së sundimit osman, interesimi i qarqeve intelektuale të Evropës motivohej kryesisht nga bashkëdhimbja për vëllazërit e tyre në Krisht e që vuanin nën “zgjedhën turke”, ndërsa intervenimi i Fuqive të Mëdha evropiane gjithashtu ishte me pretekstin e mbrojtjes së të krishterëve, kurse përpjekjet e zgjidhjes së problemit maqedonas e presupozonin dikotominë dhe konfliktin në mes “shtypësve muslimanë” dhe “viktimize të krishtera”. Por nga fiksimi i faktorëve evropianë vetëm tek dimensionin fetar dhe shpërfillja e konfliktit brendakrishter me motiv kombëtar, rezultoi te një keqmenaxhim katastrofik i Çështjes Maqedonase me pasoja të mëdha për krishterët e Maqedonisë që u takonin grupeve të ndryshme etno-kombëtare dhe për të cilët faktorët qeveritarë, e në veçanti ato joqeveritarë të Evropës, ishin të brengosur aq shumë.

⁷ Almusayid, A. S. (n.d.). *Abbasid Revolution*. King Saud University.
<https://faculty.ksu.edu.sa/en/aalmusayid/page/132143>

Për origjinën e konfliktit mes të krishterëve ortodoksë, nevojitet elaborim i një konteksti më të gjerë të Perandorisë Osmane. Sistemi i saj i mileteve u mundësonte krishterëve autonomi të caktuar. Por njëkohësisht, ky sistem mundësoi edhe keqpërdorimin e pozitës së Patrikanës së Stambollit me qëllim shtypjen e kulturave të ortodoksëve jogrekë, e deri te përpjekja për asimilim të tyre.⁸ Një zhvillim kyç në këtë aspekt ishte shuarja e Arqipeshkvisë së Ohrit më 1777, pas çka priftërinjtë grekë fituan kontroll të plotë shpirtëror mbi ortodoksët e Maqedonisë, dhe sllavët u bënë cak i përpjekjeve për helenizim nga shkollat dhe kishat greke, gjë që në vitet 1840 nxiti përpjekjet e elitës bullgare për rikthim të një kishe autonome dhe fillimin e lëvizjes kundër helenizmit.⁹ Këto përpjekje kulminuan më 1870 me fermanin e Sulltanit që e themeloi Ekzarkatin Bullgar, gjë që çoi në disa fërkime me eksponentët e Patrikanës së Stambollit mbi kufijtë e shtrirjes së Ekzarkatit.¹⁰ Përpos kësaj, nevojitet të përmenden edhe disa zhvillime të tjera politike dhe juridike në Perandorinë Osmane të shekullit XIX, kur ndërmori disa reforma për përmirësimin e pozitës së jomuslimanëve, që kulminuan me Hatt-i sherifin (Ediktin) e Gjylhanes së vitit 1839.¹¹ Megjithatë, këto reforma nuk i shuan përpjekjet për shkëputje të popujve të krishterë dhe njëkohësisht shkaktuan pakënaqësi edhe tek disa muslimanë që nuk pajtoheshin me humbjen e autonomisë nga centralizimi i pushtetit. Kështu që, si rezultat i mospajtimit me sundimin osman (para dhe pas reformave), disa popuj në Ballkan, ose disa sundimtarë lokalë që e kishin lojalitetin e një pjese të madhe të popullit, u çuan në kryengritje kundër pushtetit osman.^{12, 13} Shumica e rebelimeve u shuan me sukses, por disa të tjera rezultuan me humbje territoriale për Perandorinë Osmane në Rumeli. Më 1830 u njoh pavarësia e plotë e Greqisë dhe ajo *de facto* e Serbisë që *de jure* mbeti nën Perandorinë Osmane. Dhe, në të njëjtin shekull të këtyre reformave dhe ndryshimeve territoriale, në Ballkan ndodhi edhe një fenomen tjetër me rëndësi: paraqitja e nacionalizmit dhe vendimet politike bazuar te aspiratat nacionaliste.

Logjika me të cilën Evropa e perceptonte Ballkanin si një përballje epike mes muslimanëve dhe të krishterëve, nënkuptonte një unifikim të fortë të banorëve të krishterë, elitës së tyre dhe shteteve-kombe të tyre, në një vëllazëri në Krisht kundër muslimanëve, por ja që nuk ndodhi kështu. ProjekSIONET nacionaliste të shteteve fqinje, si edhe fërkimet e brendshme në

⁸ Feraj, H. (1998) *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Koha”, 41 (fusnota)

⁹ Aabake, V. (2003) *Ethnic Rivalry and the Quest for Macedonia 1870-1913*, Boulder, CO.: East European Monographs, 42

¹⁰ Po aty, 45-46

¹¹ Xhemaili, V. (2012) *Shqiptarët e Maqedonisë së sotme: nga Kryengritja e Dervish Carës 1834 deri te Kryengritja e Dibrës 1913*, Tetovë: Tringa Design, 18

¹² Sheldija, Gj. *Kronologjia Historike, Maqedonia Shqiptare*, 2009, Shkup, 65

¹³ Nexhipi, R. (2009) *Sprovë për një Kronologji Historike të Maqedonisë Shqiptare, Maqedonia Shqiptare*, Shkup, 289

mes ortodoksëve të Maqedonisë osmane mbi çështjet kishtare, fillimisht nuk përfshinin edhe dhunë vdekjeprurëse. Ndryshimet që në fund do të rezultojnë edhe me zhvillime të tilla, origjinën e kanë te viti kyç 1878.

Me Traktatin e Shën Stefanit që i dha fund Luftës Ruso-Turke të viteve (1877-78) u parapa krijimi i një Bullgarie me territor gjigand, nga brigjet e Detit të Zi deri në Korçë. Një shtet i tillë bullgar ishte humbje e madhe për Perandorinë Osmane muslimane dhe sipas logjikës së perceptimit të botës “muslimanët vs. të krishterët”, ky përbënte lajm të mrekullueshëm për të gjithë të krishterët. Por ndodhi tërësisht e kundërta dhe pati reagime negative te shtetet fqinje ortodokse: Greqisë dhe Serbisë, te shqiptarët krishterë që këtu e kishin të njëjtin qëndrim me bashkatdhetarët muslimanë dhe nga Fuqitë e tjera të Mëdha si Austro-Hungaria dhe Britania e Madhe, sepse i prekte interesat e tyre¹⁴ dhe sepse ai shtet bullgar i themeluar nga iniciativa ruse, do të ishte vegël e interesave ruse.¹⁵ Nga retrospektiva e mëvonshme, historianët bullgarë e kanë vendosur tezën nëse Rusia cariste qëllimisht ka marrë vendim për krijimin e shtetit aq të madh bullgar duke e ditur paraprakisht se do të jetë i papranueshëm nga fuqitë tjera evropiane, ashtu që ta pranojë revidimin e Bullgarisë së Shën Stefanit, duke marrë si kompensim nga territoret osmane në Kaukaz dhe Besarabinë.¹⁶ Pra, Rusia cariste, i shfrytëzoi vëllezërit sllavë dhe ortodoksë thjeshtë si një monedhë këmbimi për të përfituar për interesat e saj imperialiste.

Si rezultat i gjithë atyre pakënaqësive nga palët e ndryshme me “Shën Stefanin”, u mbledh Kongresi i Berlinit i vitit 1878. Dhe me Traktatin e Berlinit i cili e shfuqizoi Traktatin e Shën Stefanit, është pikërisht origjina e Çështjes Maqedonase që u bë mollë sherri që atëherë në mes Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë (me kufij shumë më të vegjël se të Shën Stefanit).¹⁷ Pra, Çështja Maqedonase origjinën e kishte te mospajtimet e vetë Fuqive të Mëdha evropiane, që u reflektua si rivalitet mes shteteve ortodokse dhe përballjeve mes çetave të armatosura mbrapa të cilave qëndronin. Nga trupi i përbashkët i krishterë në të cilin fshatarët e perceptonin veten, çetat e armatosura dhe shtetekombe fqinje që qëndronin mbrapa tyre, dëshironin të nxjerrin përkatësi kombëtare. Dhe kjo dhunë përfshinte edhe djegien e kishës bullgare apo greke të fshatit, si edhe vrasjen e personave më në zë të palës kundërshtare.¹⁸

¹⁴ The Editors of Encyclopaedia Britannica (24 shkurt 2025). *Treaty of San Stefano. Encyclopedia Britannica*. <https://www.britannica.com/event/Treaty-of-San-Stefano>

¹⁵ Buxhovi, J. (2012) *Kosova (Perandoria Osmane)*, Prishtinë&Houston: Jalifat Publishing, 201

¹⁶ Атанасоски, Б. (2022) *Историскиот македонизам е лага во која пронаѓа нашата иднина!*, Словен Печат, <https://www.slobodenpecat.mk/istoriskiot-makedonizam-e-laga-vo-koja-propagja-nashata-idnina/>

¹⁷ Danforth, L. (23 mars 2023). *Macedonian Question. Encyclopedia Britannica*. <https://www.britannica.com/event/Macedonian-Question>

¹⁸ Livianos, D. (2008): Beyond ‘ethnic cleansing’: aspects of the functioning of violence in the Ottoman and post-Ottoman Balkans, *Southeast European and Black Sea Studies* 8:3, London: Routledge, 89-203

Vetë evropianët dëshmitarë

Sidoqoftë, fokusi i qarqeve evropiane ishte dhe mbeti tek konflikti i aspektit fetar “muslimanët vs. krishterët”, duke u shpërfillur aspekti etno-kombëtar i larmisë dhe konfliktit në Maqedoni për të cilët ishin dëshmitarë edhe shumë prej tyre, disa edhe duke thënë që këto grupe kanë më shumë urrejtje apo armiqësi mes vete sesa që kanë ndaj “turkut” (lexo “osmanliut”) që të gjithë e kishin mbi kokë. Për shembull, gazeta britanike “Pall Mall”, në gusht të vitit 1903 raportonte se çetat ekzarkiste dhe patriarkiste, e urrejnë njëri-tjetrin më shumë sesa turkun.¹⁹ Ngjashëm në dhjetor të po atij viti, në revistën “Popular Science” që në kohën moderne shquhet për raportime senzacionaliste, por në të kaluarën ishte burim më i besueshëm i informacionit, raportonte për mosbesimin dhe urrejtjen e ndërsjellë në mes “racave” të krishtera, sado që mbi vete e kishin “turkun” që e urrenin të gjithë.²⁰ Dhe në prill 1904, madje edhe gazeta katallane “La Veu de Catalunya” raportoi se si “patrikanat greke dhe serbe luftonin kundër Ekzarkatit bullgar duke e harruar antipatinë e përbashkët kundër turqve”.²¹

Këto ishin raportime gazetareske, ndërsa nga aktorët shtetërorë që e konfirmojnë gjendjen e konfliktit, shquhet raporti i ambasadorit gjerman në Perandorinë Osmane, ku thotë: “urrejtja e ndërsjellë mes krishterëve të kombësive të ndryshme, është faktor shumë më i fortë për anarkinë, sesa konfrontimi në mes Krishterimit dhe Islamit”.²²

Për banorët e thjeshtë të Ballkanit osman, deri në mesin e shekullit XIX, identiteti primar ishte ai i të qenit musliman apo krishter.²³ Por, me ardhjen e nacionalizmit etnik edhe në Ballkan, te njerëzit fillon të paraqitet edhe vetëdija etnike, kurse me projeksionet nacionaliste për të ardhmen, fitoi relevancë politike vazhdimisht e më të madhe edhe diversiteti etnik shumë i lartë i Maqedonisë, për të cilin Evropa ishte e vetëdijshme shumë dekada para se të aktualizohet Çështja Maqedonase nga Kongresi i Berlinit i vitit 1878, aq sa kjo përzierje demografike ndikoi që në pjesën e parë të shekullit XIX, mbiemri

¹⁹ Bozeva-Abazi, K. (shkurt 2003) *The Shaping of Bulgarian and Serbian National Identities, 1800s-1900s*, Montreal: McGill University, 166

²⁰ McLAUGULIN, A. (dhjetor 1903) *The Storm Center in the Balkans*. The Popular Science Monthly, volume LXIV. (December 1903), 174-176

²¹ Esculies, J., Da Cal, E.U., Pich, J. (2013) Catalan Nationalist Perspectives on the Ilinden Uprising of 1903, *Journal of History year. XLVIII, No 1*, Skopje: Association of the Historians of the Republic of Macedonia, 107-132

²² Valkov, M. (2010) *The Internal Macedonian-Adrianople Revolutionary Organization and the Idea for Autonomy for Macedonia and Adrianople Thrace, 1893-1912*, Budapest: Central European University – Department of History, 50

²³ Ibrahim, Z. (2021) Transformimet Identitare në Ballkan, *Ballkanologjia -3- Akte të konferencës shkencore ndërkombëtare: Ballkanologjia sot dhe Komunikime Ndërbalkanike - Ballkani midis mitit, realitetit dhe perspektivës*, Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, 118-149

“maqedonase” të paraqitet si term kulinarik për të përshkruar gjellëra dhe sallata me përzierje të madhe të përbërësve ashtu siç është i përzier territori i Maqedonisë.²⁴ Megjithatë, marrëveshja e parë ndërkombëtare që kishte të bëjë me të njëjtën, Traktati i Berlinit i vitit 1878,²⁵ më saktë neni XXIII,²⁶ nuk përmbante asnjë dispozitë me të cilën mbahej llogari për këtë diversitet etnik, e aq më pak që në bazë të këtij diversiteti të vendoste ndonjë rregullim më specifik qeverisës. Por, me atë nen, parashihej që në Maqedoni të vendoset një skemë mjaft e gjerë e ndarjes së pushtetit bazuar në dikotominë “muslimanët vs. të krishterët” sipas modelit të Ligjit Organik të Kretës së vitit 1868. Sipas këtij dokumenti, në Maqedoni do të vendoseshin disa aspekte qeverisëse dhe gjyqësore në bazë të ndarjes në mes muslimanëve dhe krishterëve, si ajo që gjysma e sanxhaqeve të jenë me mytesarif (guvernator provincial) musliman ndërsa gjysma tjetër me të krishterë; në kontestet ku njëra palë është muslimane ndërsa tjetra është krishtere, të gjykojë mes tyre një tribunal i përzier, etj.²⁷ Meqenëse neni gjegjësisht i Traktatit të Berlinit këtë e la nën diskrecionin e Portës së Lartë pa afat se deri kur duhet të zbatohet, autonomia e Maqedonisë nuk u zbatua asnjëherë. Por prapëseprapë meriton të përmendet si projekti më i hershëm i Fuqive të Mëdha për Maqedoninë, me të cilin mund të bëhet hamendje e bazuar se nuk do të mjaftonte për të vendosur paqe në Maqedoni. Sepse, në rastin e Kretës, kishim të bëjmë me një ishull të vogël, me popullsi të vogël, ku ndarja e popullsisë ishte në mes kretasve krishterë dhe kretasve muslimanë (me një numër jo aq të madh të kolonistëve turq), por te rasti i Maqedonisë kishim të bëjmë edhe me larmi të madhe etnike në antagonizëm të fuqishëm mes vete.²⁸ Edhe nëse krishterët e thjeshtë do të mjaftoheshin nga ndonjë skemë e pushtetndarjes bazuar në dikotominë muslimanët vs. krishterët, vështirë se një skemë e tillë do t’i qetësonte grupet e armatosura me aspirata kombëtare që morën hov me mbështetjen e shteteve fqinje që kishin qëllime ekspansioniste ndaj Maqedonisë osmane.

²⁴ Merriam-Webster. *Macédoine*.

<https://www.merriam-webster.com/dictionary/mac%C3%A9doine>

Collins Dictionary. *Macedoine*.

<https://www.collinsdictionary.com/dictionary/english/macedoine>

Murati, Q. (2011) Shqiptarët e Maqedonisë në “Enciklopedinë Maqedonase” - Trillimet dhe Realiteti, *Studime Albanologjike* 4, Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, 255

²⁵ Treaty between Great Britain, Germany, Austria, France, Italy, Russia, and Turkey for the Settlement of Affairs in the East: Signed at Berlin, July 13, 1878. (1908). *The American Journal of International Law*, 2(4), 412. <https://doi.org/10.2307/2212670>

²⁶ Që nuk e përmendte direkt Maqedoninë por që në hartat e miratuara nga Kongresi i Berlinit, nën “Turqinë Evropiane” hynte edhe Maqedonia bashkë me Rumelinë, Shqipërinë, Kosovën dhe Sanxhakun. Shih: Габер, В. (2017) *Од објект до субјект: Македонија во меѓународните односи*, Скопје: Фондација “Фридрих Еберт”, Канцеларија во Македонија, 56

²⁷ Firman. Organic Regulations for Crete, 23 Aug.1868 (1920), *Greece with the Cyclades & Northern Sporades*, London: H. M. Stationery Office, 159-162

²⁸ Aarbakke, 62

Sado që në këtë periudhë të hershme (1878), ende nuk pati plasur ai konflikt i ashpër në mes krishterëve me etni të ndryshme, kjo prapëseprapë nuk i shfaqëson Fuqitë e Mëdha, sepse atë perceptim dhe logjikë të shpërfilljes së konfliktit nacionalist e mbajtën gati se kryekëput deri në muzgun e fundit të sundimit osman mbi Maqedoninë në vitin 1912. Nga ana tjetër, përderisa ende vijonte me punë Kongresi i Berlinit (1878-1881), palët vendase dërguan dy projekte për autonomi të Maqedonisë, ku në qeverisjen e së cilës, do të mbahej llogari edhe për larminë etno-kombëtare të Maqedonisë. E para prej këtyre ishte një petition i datuar më 5 prill 1880 i një grupi të nënshkruarish si bullgarë të disa qyteteve të Vilajetit të Manastirit, që ua drejtuan Fuqive të Mëdha, ku gjithashtu kërkohej për Maqedoninë një autonomi me ndarje të pushtetit mes muslimanëve dhe të krishterëve, si p.sh. që aty ku shumica janë krishterë, udhëheqësi të jetë krishter ndërsa “muavini” (zëvendësi) i tij të jetë “turk” (musliman). Por te ky petition kërkohej edhe rekrutim për administratën (guvernatorë, gjykatës, xhandarë) me ndarje proporcionale sipas numrit të secilës nga kombësitë që jetojnë në Maqedoni.²⁹

Një përpjekje tjetër e personave që rridhnin nga popullata vendore, po ashtu më 1880, është aksioni politik i quajtur Lidhja Maqedonase, që u theme-lua në Sofje me emrin Lidhja Bullgaro-Maqedonase, pastaj Lidhja Maqedonaso-Bullgare dhe në fund me emërtimin e lartpërmendur.³⁰ Në një dokument të kësaj organizate të titulluar “Kushtetuta për Rregullimin Shtetëror të Ardhshëm të Maqedonisë”, Maqedonia shpallet “shtet autonom i popullit maqedonas dhe kombësive që jetojnë në kufijtë e saj: turq, arnautë, grekë, hebrenj, vllahë, jevgë, etj.”³¹ Pra, në mënyrë eksplicite e njihnin dimensionin etno-kombëtar të larmisë së Maqedonisë. Dhe në shumë nene të kushtetutës, nga gjithsej 103, parashihnin më shumë aspekte ku kjo larmi do të pasqyrohej në pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv të shtetit të propozuar autonom të Maqedonisë. Si p.sh., nenin 4 që thotë: “guvernatorin e përgjithshëm dhe ndihmësin e tij i zgjedhë Kuvendi Kombëtar i përbërë nga të gjitha kombësitë sipas numrit të grupit kombëtar”. Dhe në nenin 22 përshkruhet numri i tyre: “45 maqedonas-sllavë, 20 turq, 7 shqiptarë, 3 hebrenj, 3 grekë dhe 2 vllahë.”³²

²⁹ Edhe pse nuk përmendet Maqedonia me emër por të nënshkruarit prezantohen si bullgarë të Vilajetit të Manastirit dhe në fund janë të vendosura vulat e “5 komunave bullgare”: Manastirit, Ohrit, Velesit, Follorinës dhe Prishtinës. - Прошение на българите от Биголския вилает до Европейската комисия в Цариград с искания за реформи, *Сборник от документи и материали* (1978), София: Българска академия на науките, 365-367

³⁰ Trencsényi, B., & Kopeček, M. (2007). Two Macedonian manifestos. *National Romanticism: The Formation of National Movements: Discourses of Collective Identity in Central and Southeast Europe 1770–1945, volume II*. Central European University Press. 481

³¹ Мојаноски, Ц.Т. (2002) *Основи на Општественото Уредување (Основи на политичкиот систем)*, Штип: Педагошки факултет „Гоце Делчев“, 31

³² Фрчковски, Љ.Д. (2023) *Бележки за македонскиот конституционализам: концепт на Уставот од 1991*, Скопје: Цивил - Центар за слобода, 31-32

Përpos këtyre dy që u përmendën, deri më 1913 pati edhe shumë iniciativa të tjera për zgjidhje të mosmarrëveshjeve përmes ndonjë autonomie ku në qeverisjen e Maqedonisë do të merrej parasysh edhe larmia etnike në vend se vetëm atë *stricto sensu* fetare, që iu dërgua Fuqive të Mëdha prej aktivistëve politikë të Maqedonisë nga rryma të ndryshme, edhe atë: të majtë apo të djathtë; qofshin ato qarqe të cilët sllavët e Maqedonisë i konsideronin popull të veçantë, apo të tillë që i konsideronin bullgarë; pa marrë parasysh nëse bëhej fjalë për qarqe që avokonin për distancim politik edhe nga Bullgaria, qofshin qarqe fare të afërta me qeverinë bullgare.

Propozimet evropiane

Nga ana tjetër, Fuqitë e Mëdha evropiane, nga 1878 deri në shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike më 1912 kur keqmenaxhimi i tyre i Maqedonisë shkaktoi kolaps total, i mbetën besnikë dimensionit fetar të problemit. Me një përjashtim të vetëm nga viti kyç 1903 që do ta përmendim më vonë, por që edhe ajo dështoi në mënyrë spektakulare. Por para se të dalim aty, duhet përmendur edhe një tjetër propozim që u mor seriozisht dhe që po ashtu dëshmon se sa mungonte sensi i realitetit te fuqitë evropiane në perceptimin dhe menaxhimin e Çështjes Maqedonase.

Një ide për reformim rrënjësor të Maqedonisë osmane që u plasua nga Rusia, Austro-Hungaria dhe Mbretëria e Bashkuar, ishte vendosja e një rregullimi të Maqedonisë sipas modelit të Libanit. Bëhej fjalë për "Règlement"-in që më 1861 Fuqitë e Mëdha e vendosën në Liban. Sipas këtij sistemi, Libani u nda në kantone dhe distrikte sipas linjave sektare, ndërsa edhe qeverisja dhe përfaqësimi në këto territore duhej reflektuar përbërjen sektare të atij rajoni administrativ.³³ Por sërish, edhe kjo ishte joadekuate për Maqedoninë, sepse ndarja sektare nuk ishte aq e theksuar, ku kishte një numër jo aq të madh të bektashinjve që ishin pjesë e pandashme e muslimanëve sunitë, ndërsa te të krishterët kishte një prani diçka më të madhe të katolikëve dhe më të vogël të protestantëve, por që nuk përbënin ndonjë prani kompakte territoriale që do të çonte në nevojë për t'u ndarë në njësi të veçanta territoriale për ta. Në Maqedoni përbënte rast interesant Goce Dellçevi që ishte krishter uniat, por në aktivizmin e tij politik ishte një me bashkëkombësit e tij ortodoksë dhe ishte mësues i Ekzarkatit. Ndërkaq, edhe ndarja mes kësaj të fundit nga Patrikana e Stambollit nuk kishte karakter sektar, sepse të dyja palët i takonin ortodoksisë. Kështu që, sistemi sektar i Libanit, vështirë se do të vendoste stabilitet në Maqedoni me realitetin e saj të diversitetit ekstrem etnike dhe

³³ Brooks, J. (2014) *Managing Macedonia: British Statecraft, Intervention, and 'Proto-peacekeeping' in Ottoman Macedonia, 1902-1905*, Simon Fraser University: Department of History - Faculty of Arts and Social Sciences, 687-689

aspiratave të kundërta kombëtare që çuan në konflikt të ashpër mes besimtarëve të të njëjtit religjion dhe sekt.

Ideja që Maqedonia të rregullohet sipas modelit të Libanit u diskutua në qarqet diplomatike para dhe gjatë Kryengritjes së Ilindenit, për karakterin e së cilës ka shumë kundërthënie në qarqet akademike, por për qëllimet e këtij punimi, shkurt duhet përmendur se një pjesë e madhe e ngjarjeve, ishte dhuna e ashpër sipas perceptimit “Islami vs. Krishterimi” që evropianët e kishin mbi Rumelinë. Kështu që, kryengritësit i sulmonin fshatrat muslimane, që pastaj reprezaljet e ashpra të bashibozukëve dhe trupave osmane, të nxisin intervenimin e Fuqive të Mëdha duke ia dhënë autonominë Maqedonisë. Vetë fakti që kryengritja ishte planifikuar për, dhe shpërtheu në Ilinden, domethënë Ditën e Shën Ilisë, tregon për karakterin e fortë krishter të Kryengritjes dhe motivin se për mirëqenien e kujt janë ngritur në kryengritje: disa raporte konsullore të kohës raportojnë se kryengritja u mirëprit nga popullsia e krishterë “gjithkund”.³⁴ Por, qëndrimi i popullsisë krishtere jobullgare/josllave nuk del aq universalisht entuziast pro kryengritjes. Kështu që, përpos fshatrave muslimane, kryengritësit sllavë/ekzarkistë i sulmuan edhe disa fshatra patriarkiste³⁵. Në kundërpërgjigje, diplomatët grekë iu ndihmuan osmanëve në shtypjen e kryengritjes³⁶ dhe çetat greke u kyçën në luftime direkte kundër çetave sllave.³⁷ Dhe kur u afrua fundi i kryengritjes, mitropolitët grekë e shfrytëzuan situatën e vështirë të maqedonasve ekzarkistë, duke i joshur që të kalojnë tek Patrikana e Stambollit si mundësi për t’u mbrojtur nga reprezaljet osmane.³⁸ Madje, mbështetje universale nuk pati as nga vllahët që me të vërtetë shquhen si mbështetësit më të mëdhenj josllavë të kryengritjes së Ilindenit. Edhe pse kishte një numër të madh të tyre që luftuan pro kryengritjes, shumë vllahë të tjerë i mbetën lojalë pushtetit osman.³⁹

Pasi që nuk erdhi intervenimi i shpresuar nga Evropa që do ta sillte autonominë e Maqedonisë, osmanët e shtypën kryengritjen me pasoja të ashpra ndaj popullsisë krishtere, edhe atë pa kursyer as vllahët dhe grekët patriarkistë që nuk e patën mbështetur kryengritjen. Por kjo shtypje e përbashkët e tyre, prapëseprapë nuk e bashkoi popullsinë e larmishme të krishterë,

³⁴ Mazllami, Z. (2021) The Ilinden Uprising, *Philosophica International Journal of Social and Human Sciences* 15-16/8/2021, Tetovo: University of Tetova, 128-131

³⁵ Yosmaoğlu, İ. (2014). *Blood Ties: Religion, Violence, and the Politics of Nationhood in Ottoman Macedonia, 1878–1908*, 35

³⁶ Aarbakke, 112

³⁷ Gounaris, B. K. (1992) The Macedonian Struggle 1903–1912. Paving the Way for the Liberation. *Modern and Contemporary Macedonia*, vol. 1, Thessaloniki: Papazisis Publishers & Paratiritis Publishing House, 508–529

³⁸ Vamvakovski, D. L. (2012) Greek-Macedonian Struggle: The Reasons for its Occurrence, *Macedonian Historical Review* 3, Skopje: University of Ss. Cyril and Methodius - Faculty of Philosophy, 117-131

³⁹ Puttkamer, J. (2017). The Vlachs of Krushevo. Nationalism and Violence in the Ilinden Uprising (sic). *Südost-Forschungen*, 76(1), 217-240. <https://doi.org/10.1515/sofo-2017-760113>

përkundrazi, pas vitit 1903, vetëm se u thelluan dhe u ashpërsuan ndasitë mes tyre. Kryengritja e Ilindenit i alarmoi dhe i nxiti grekët të riaktivizohen në përballjet mbi Maqedoninë, u paraqitën thirrje për bojkot të bizneseve dhe u shpeshuan sulmet vdekjeprurëse të figurave më të suksesshme të palës tjetër.⁴⁰ Në Krushevën që u bë simbol i bashkëpunimit multi-etnik dhe multi-konfesional, u thelluan ndarjet mes muslimanëve dhe krishterëve, mes sllavëve dhe vllahëve, ndërsa brenda këtyre të fundit, edhe mes rumunofilëve dhe grekofilëve.⁴¹ Një shkaktar direkt për ashpërsimin e dhunës në Maqedoni në mes ortodoksëve pas vitit 1903, ishte një dispozitë e një pakoje reformash që Fuqitë e Mëdha u morën vesh për ta zbatuar në Maqedoni. Bëhet fjalë për Programin e Reformave të Myrsteget, që para së gjithash kishte të bëjë me vendosjen e kontrollit ndërkombëtar në Maqedoni në aspekte të ndryshme. Për këtë qëllim territori u nda në pesë zona të influencës: Shkupin e mori Austro-Hungaria, Manastirin e morën italianët, Serezin francezët, Dramën britanikët, kurse rusët e morën Selanikun, aty ku gjermanëve iu dha kontrolli mbi drejtorinë e shkollës së xhandarmërisë.⁴²

Por, "Myrsteget" përmbante edhe disa dispozita për disa ndryshime që kishin të bëjnë me popullsinë lokale, si gjithmonë, sipas formulës që edhe muslimanët edhe të krishterët konsideroheshin monolit në religjionet përkatëse. Kështu, Programi i Myrsteget kërkonte riorganizim të institucioneve administrative dhe juridike ku do t'u jepej qasje krishterëve vendas dhe do të formohen komisione të përziera mes muslimanëve dhe krishterëve për shqyrtimin e krimeve të bëra gjatë trazirave.⁴³ Megjithatë, te kjo pako reformash, për herë parë Fuqitë e Mëdha evropiane propozuan një zgjidhje që e njeh edhe dimensionin etnik të problemit në Maqedoni, sepse, sipas nenit të tretë, qeveria osmane duhej të bëjë delimitim të ri të njësive administrative me qëllim të grupimit më të drejtë të kombësive të ndryshme.

Programi i Myrsteget merret si një rast pararendës i operacioneve ndërkombëtare të sotme paqeruajtëse. Por në realitet, pas një paqeje fare të shkurtër, dhuna në Maqedoni u rikthye përkundër prezencës së xhandarëve evropianë. Madje, siguria jo vetëm që nuk u përmirësua por edhe u përkeqësua. Sipas një përlllogaritjeje, mes viteve 1903 dhe 1908, numri i të vrarëve në Maqedoni ishte rreth 8 mijë, prej të cilëve 3,500 guerilë dhe të tjerët civilë.⁴⁴ Si ironi e fatit, një nga arsyet e përkeqësimit të dhunës ishte pikërisht dispozita e vetme e atij programi ku mbahej llogari për dimensionin etno-kombëtar të konfliktit në Maqedoni dhe që kishte për qëllim ta zbusë atë. Dispozita që

⁴⁰ Gounaris, B. (2001) From Peasants into Urbanites, from Village into Nation: Ottoman Monastir in the Early Twentieth Century, *European History Quarterly* Vol. 31 No. 1, SAGE Publications, 43-63

⁴¹ Puttkamer, 235

⁴² Esculies, J., Da Cal, E.U., Pich, J., 129

⁴³ Aarbakke, 115

⁴⁴ Yosmaoğlu, 41

kufijtë administrative të rishikohen sipas parimit të kombësisë, vetëm se kontribuoi në rritjen e aktiviteteve të armatosura, meqë palët ndërluftuese këtë e shihnin si shenjë e parë që hapat e radhës së reformave janë drejt autonomisë dhe ndarjes në bazë të kufijve të kombësive.⁴⁵ Ishin pikërisht rrethanat e dhunshme që u shkaktuan nga neni 3 i “Myrsteget” mbi delimitimin e njësive administrative që i nxiti edhe shumë shqiptarë me bindje kombëtare të dalin jashtë karakterit të lëvizjes kombëtare shqiptare që realizimin e interesave kombëtare e kërkonin përmes rrugës legale, zyrtare dhe lobimit të huajt, por tashmë edhe shqiptarët formuan çeta me qëllim mbrojtjen e interesave kombëtare para ndryshimeve vendimtare të pritura.⁴⁶ Madje edhe në Krusheven që gjatë Ilindenit u pat bërë simbol i tejkalimit të ndasive, kjo dispozitë shkaktoi përballje të ashpra mes njerëzve, të motivuar nga aspiratat nacionaliste greke, bullgare dhe rumune.⁴⁷ Kështu që, sërish u konfirmua shkurtpamësia e qarqeve evropiane që e patën shpërfillur aspektin kombëtar të Çështjes Maqedonase, ndërsa kur më në fund e njohën dimensionin etno-kombëtar të problemit, Fuqitë e Mëdha e keqmenaxhuan me pasoja të rënda.

Ky projekt i tyre zgjati deri te revolucionin xhonturk i vitit 1908, sepse me rivendosjen e kushtetutës osmane dhe të drejtave që ajo i përfshinte, Fuqitë e Mëdha evropiane e humbën pretekstin e përzierjes mbi Maqedoninë në mbrojtje të të krishterëve, por edhe kishte optimizëm të vërtetë te ta (me rezervime) se prej tani gjërat mund të shkojnë më mirë. Ky optimizëm bazohej edhe te mbështetja entuziaste që shumica e krishterëve vendas ia dhanë revolucionit xhonturk, madje edhe çetat zbritën nga malet në qendrat administrative të Selanikut, Shkupit dhe Manastirit, që të betohen në besnikëri ndaj kushtetutës duke i dorëzuar edhe armët.⁴⁸

Por revolucionin xhonturk shpejt doli dëshpërim për ta. Disa nga faktorët më të përmendur në burimet e ndryshme janë centralizimi i pushtetit dhe përpjekja për shkombëtarizim të tyre duke zbatuar osmanizim, që çuan te riaktivizimi i çetave të ortodoksëve dhe vendosja e bashkëpunimit mes tyre përkundër faktit se nuk u patën tejkaluar mosmarrëveshjet mbi çështjet kishtarë dhe shkollore. Në dallim prej më herët, në periudhën 1909-1912 me të vërtetë shumica e dhunës ishte sipas perceptimit të Evropës “muslimanët vs të krishterët”.⁴⁹ Si rrjedhojë, nëse dikur çetat greke, bullgare dhe ato autonomiste maqedonase bashkëpunonin me osmanët kundër njëri-tjetrit, tashmë

⁴⁵ Po aty, 46

⁴⁶ Skendi, S. (1967) *The Albanian National Awakening 1878-1912*, Princeton, New Jersey: Princeton University Press, 207

⁴⁷ Минов, Н. (2017). Зошто и како беа интернирани крушевските Власи за време на Првата светска војна?, *100 години од прогласувањето на влашкиот принципат Пинд и 100 години од интернирањето на Власите*, Скопје: Integra Nau, 127-142.

⁴⁸ Aarbakke, 145-146

⁴⁹ Papaioannou, S.S. (2012) *Balkan Wars Between the Lines: Violence and Civilians in Macedonia, 1912-1918*, College Park: University of Maryland, 100

filloi të ndodhë e kundërta, duke bashkëpunuar ngushtë kundër caqeve osmane.⁵⁰ Por prapëseprapë ky bashkëpunim i tyre ishte sporadik, ngaqë ata nuk u bashkuan në një front të përbashkët dhe të krijohej një identitet i vetëm grupor mes të krishterëve në Maqedoni në përputhje me perceptimin monolitik që Evropa e kishte për ta. Madje pas paqes së shkurtër, u rikthye përballja mes tyre si dikur, edhe atë, mes çetave të grekëve e bullgarëve në Maqedoni nuk u ndalën incidentet as pasi që shtetet-kombe amë përkatëse, Greqia dhe Bullgaria, në tetor 1912 publikisht deklaruan Aleancën Ballkanike.⁵¹

Para se të shpërthejë Lufta e Parë Ballkanike mes shteteve ortodokse ballkanike dhe Perandorisë Osmane, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Rusia, ndërmorën përpjekje të fundit për të evituar luftën përmes një note diplomatike që në emër të Koncertit të Evropës iu dërgua shteteve ortodokse ballkanike. Aty refuzohej kategorikisht ndryshimi i status *quo*-së territoriale dhe cenimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të Perandorisë Osmane, theksohej se Fuqitë e Mëdha janë të gatshme ta marrin përsipër implementimin e reformave në Maqedoni bazuar te neni 23 i Traktatit të Berlinit (1878). Pra, në vitin 1912 kur kishin ndryshuar shumë gjëra, Fuqitë e Mëdha u përpoqën ta shpëtojnë situatën përmes kthimit në agjendën 1878. Por kjo ofertë u refuzua nga Perandoria Osmane me arsyetimin se neni 23 nuk ka të bëjë me situatën aktuale dhe se parlamenti osman do ta përpilojë një skemë të re të reformave për qeverisjen e Rumelisë. E njëjta u refuzua edhe nga Aleanca Ballkanike me arsyetimin se tashmë ishte shumë vonë që të presin veprime nga shtetet e mëdha evropiane.⁵²

Kështu, më tetor 1912 shpërtheu Lufta e Parë Ballkanike, që aleatët ortodoksë e filluan me retorikë kryqëzate për “çlirimin” e krishterëve nga “zgjedha turke”, ndërsa edhe popullsia vendore mirëpriste pa dallim etnie dhe nga cilido shtet të jetë ajo ushtri.⁵³⁵⁴ Por shpejtë erdhi zhgënjimi i tyre, sepse, pas konsolidimit të pushtetit të secilit shtet në zonat përkatëse, ndodhi edhe zgjimi i vrazhde i nacionalizmit etnik, me të cilin të krishterët e Maqedonisë kishin përvojë të hidhur prej më herët, por tashmë e shijuan edhe kur atë e zbaton fuqia e tërë autoritetit shtetëror. Kështu, pas vendosjes së kontrollit në zonat e “çliruara” përkatëse, autoritetet greke, bullgare dhe serbe, nisën të zbatojnë trajtim të pakëndshëm edhe ndaj të krishterëve të kombësisë tjetër prej atyre që e kontrollonin zonën: censurim të shtypit, keqtrajtime fizike,

⁵⁰ Po aty, 106

⁵¹ Po aty, 107-109

⁵² Harris, N.D. (1913) The Macedonian Question and the Balkan War, *The American Political Science Review*, May, 1913, Vol. 7, No. 2, Washington, D.C.: American Political Science Association, 197-216

⁵³ Papaioannou, 115-117

⁵⁴ Po aty, 120

arrestime, dëbime, përpjekje për asimilim,... në këtë kontekst madje e pësonin edhe priftërinjtë.⁵⁵⁵⁶

Pakënaqësia e Bullgarisë me ndarjen e territorit dhe dëshpërimi i sllavëve të Maqedonisë nga vrazhdesia e pushtetit serb dhe grek, në vitin 1913 çuan në tre përpjekje për rishikim të realitet në terren: kryengritja e Tikveshit, Lufta e Dytë Ballkanike dhe Kryengritja e Ohrit dhe Dibrës ku sllavët e krishterë luftuan bashkë me shqiptarët muslimanë dhe turqit, kundër Serbisë dhe Greqisë.

Të gjithë këto rezultuan të pasuksesshme, ndërsa përpjekjet e mëvonshme për rishikim të vendimeve territoriale, e vazhduan gjakderdhjen mbi Maqedoninë edhe për shumë dekada më vonë. Dhe e gjithë kjo situatë origjinën e kishte te keqmenaxhimi i Çështjes Maqedonase në periudhën e Koncertit të Evropës që vendoste mbi fatet e popujve pa i konsultuar të njëjtit dhe duke i shpërfillur iniciativat e palëve vendore që më mirë e dinin realitetin në terren dhe mund të propozonin zgjidhje më të përshtatshme për territoret e lëkundura me potencial konflikti.

Conclusion

Having a common religion has been, and will be, a powerful factor of community and solidarity among the people within a state, and a source of empathy for people in other parts of the world. And on the other hand, different religion causes an “us vs. them” worldview, which leads to hatred and interfaith conflicts. But within a man, there are also other social differences, which, when combined with the motivation for political power, territory, resources of that territory, and other driving motives, results in negative consequences that lead the believer to “forget” the fact that his rival is a coreligionist with whom they share the same path to God, whereas the achievement of worldly interests makes them become “brothers in arms” with believers of another religion.

From its beginnings in 1878 to the events of 1913 (and beyond), the Macedonian Question holds important lessons for later failures to resolve disputes around the world and today's efforts to establish and maintain peace in conflict zones. The fact that the autonomy of ill-defined Macedonia was left without a deadline for implementation and at the discretion of the Sublime Porte, testifies to the need for spatial and temporal precision of the agreements. There are also the divisions among the Great Powers themselves, the geopolitical calculations of each instead of concerted efforts of the Concert of Europe, the division of Macedonia into zones of interest and the neglect of the

⁵⁵ Papaioannou, kapitulli: *Interbellum Politics and Local Activism*, 148-168

⁵⁶ Цацков, О. & Илиева Николова, А. (2022) *Балканските Војни и Првата Светска Војна*, Штип: Универзитет „Гоце Делчев“, 68

role of local factors, the insufficient pressure on neighboring Orthodox states not to support the armed groups that were destabilizing Macedonia, and the naive expectation by the Young Turk revolution that constitutional rule with individual freedoms and equalities would suffice in a territory with huge diversity and where conflicting national aspirations had taken root.

And finally, the main topic of this paper is a lesson for ordinary people who see the world as a major confrontation between people of different religions, and this causes interreligious hatred, or have naive expectations that solidarity due to a common religion will be enough for one state to enter into war with another to save its brothers in faith, because first and foremost, governments are accountable for the national interests of the state they lead (*raison d'état*). Meanwhile, as for state factors and organizations that aim for peace in a region, the mismanagement of the Macedonian Question between 1878-1913 shows the danger of blindly fixating on any single social cleavage, such as religious or sectarian, disregarding other social differences that inspire worldviews, as well as motivate people's political activities and goals. This segment is observed to this day, e.g. in the fixation on the "Sunni vs. Shiite" divide, and the comparatively outright disregard for other social differences, which incite other calculations even in states, organizations, and individuals for whom religion plays a central role in their identity. Such as the Taliban of Afghanistan who do not recognize the Durand Line inherited from British colonialism, which today separates the Pashtuns of Afghanistan from those of Pakistan, which is a subject of interstate dispute and a risk for *casus belli*, despite their utmost proximity that stems from having a common religion.⁵⁷

Recensentë:

Prof. dr. Ali Pajaziti

Prof. dr. Murat Aliu

Bibliografia:

Aarbakke, V. (2003) *Ethnic Rivalry and the Quest for Macedonia 1870-1913*, Boulder, CO.: East European Monographs.

Akhter, M. N. (23 mars 2025). *Looking into the durand line conundrum*. The Geopolitics. <https://thegeopolitics.com/looking-into-the-durand-line-conundrum/>

Almusayid, A. S. (n.d.). *Abbasid Revolution*. King Saud University. <https://faculty.ksu.edu.sa/en/aalmusayid/page/132143>

⁵⁷ Akhter, M. N. (23 mars 2025). *Looking into the Durand Line Conundrum*. The Geopolitics. <https://thegeopolitics.com/looking-into-the-durand-line-conundrum/>

- B. McGuire, M. (2007). *Religjioni: Konteksti shoqëror*, përkth. Ali Pajaziti. Shkup: Logos-A.
- Bozeva-Abazi, K. (shkurt 2003) *The Shaping of Bulgarian and Serbian National Identities, 1800s-1900s*, Montreal: McGill University.
- Brooks, J. (2014) *Managing Macedonia: British Statecraft, Intervention, and 'Proto-peacekeeping' in Ottoman Macedonia, 1902-1905*, Simon Fraser University: Department of History - Faculty of Arts and Social Sciences.
- Buxhovi, J. (2012) *Kosova (Perandoria Osmane)*, Prishtinë&Houston: Jalifat Publishing.
- Collins Dictionary. *Macedoine*.
<https://www.collinsdictionary.com/dictionary/english/macedoine>
- Danforth, L. (23 mars 2023). *Macedonian Question*. *Encyclopedia Britannica*. <https://www.britannica.com/event/Macedonian-Question>
- Elias, A. A. (1 qershor 2021). *Tribalism and racism is ignorance in Islam*. <https://www.abuaminaelias.com/ignorance-tribalism-racism/>
- Elias, A. A. (17 korrik 2020). *Islam is against racism and prejudice*. <https://www.abuaminaelias.com/islam-against-racism-bigotry/>
- Esculies, J., Da Cal, E.U., Pich, J. (2013) Catalan Nationalist Perspectives on the Ilinden Uprising of 1903, *Journal of History year. XLVIII, No 1*, Skopje: Association of the Historians of the Republic of Macedonia.
- Feraj, H. (1998) *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Koha".
- Firman. Organic Regulations for Crete, 23 Aug.1868 (1920), *Greece with the Cyclades & Northern Sporades*, London: H. M. Stationery Office.
- Gounaris, B. (2001) From Peasants into Urbanites, from Village into Nation: Ottoman Monastir in the Early Twentieth Century, *European History Quarterly Vol. 31 No. 1*, SAGE Publications.
- Gounaris, B. K. (1992) The Macedonian Struggle 1903–1912. Paving the Way for the Liberation. *Modern and Contemporary Macedonia*, vol. 1, Thessaloniki: Papazisis Publishers & Paratiritis Publishing House.
- Harris, N.D. (1913) The Macedonian Question and the Balkan War, *The American Political Science Review*, May, 1913, Vol. 7, No. 2, Washington, D.C.: American Political Science Association.
- Ibrahimi, Z. (2021) Transformimet Identitare në Ballkan, *Ballkanologjia -3- Akte të konferencës shkencore ndërkombëtare: Ballkanologjia sot dhe Komunikime Ndërbalkanike – Ballkani midis mitit, realitetit dhe perspektivës*, Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve.
- Livanios, D. (2008): Beyond 'ethnic cleansing': aspects of the functioning of violence in the Ottoman and post-Ottoman Balkans, *Southeast European and Black Sea Studies* 8:3, London: Routledge.

Mazllami, Z. (2021) The Ilinden Uprising, *Philosophica International Journal of Social and Human Sciences* 15-16/8/2021, Tetovo: University of Tetova.

McLaugulin, A. (dhjetor 1903) *The Storm Center in the Balkans*. The Popular Science Monthly, volume LXIV. (December 1903).

Merriam-Webster. *Macédoine*. <https://www.merriam-webster.com/dictionary/mac%C3%A9doine>

Murati, Q. (2011) Shqiptarët e Maqedonisë në “Enciklopedinë Maqedonase” - Trillimet dhe Realiteti, *Studime Albanologjike* 4, Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve.

Nexhipi, R. (2009) Sprovë për një Kronologji Historike të Maqedonisë Shqiptare, *Maqedonia Shqiptare*, Shkup, 289

Pajaziti, A. (red.) (2023). *Sociologji e Islamit: Hrestomaci*. Shkup: Logos-A.

Papaioannou, S.S. (2012) *Balkan Wars Between the Lines: Violence and Civilians in Macedonia, 1912-1918*, College Park: University of Maryland.

Puttkamer, J. (2017). The Vlachs of Krushevo. Nationalism and Violence in the Ilinden Uprisin (sic). *Südost-Forschungen*, 76(1), 217-240. <https://doi.org/10.1515/sofo-2017-760113>

Qadhi, Y. (13 korrik 2015). *Ramadan 2015 Quranic Gems (20): Islam Abolished Racism 1,400 Years Ago*. YouTube. <https://www.youtube.com/watch?v=hTeo59sUSng>

Skendi, S. (1967) *The Albanian National Awakening 1878-1912*, Princeton, New Jersey: Princeton University Press.

Sheldija, Gj. Kronologjia Historike, *Maqedonia Shqiptare*, 2009, Shkup.

Treaty between Great Britain, Germany, Austria, France, Italy, Russia, and Turkey for the Settlement of Affairs in the East: Signed at Berlin, July 13, 1878. (1908). *The American Journal of International Law*, 2(4).<https://doi.org/10.2307/2212670>

Trencsényi, B., & Kopeček, M. (2007). Two Macedonian manifestos. *National Romanticism: The Formation of National Movements: Discourses of Collective Identity in Central and Southeast Europe 1770–1945*, volume II. Central European University Press.

The Editors of Encyclopaedia Britannica (24 shkurt 2025). *Treaty of San Stefano*. *Encyclopedia Britannica*. <https://www.britannica.com/event/Treaty-of-San-Stefano>

Valkov, M. (2010) *The Internal Macedonian-Adrianople Revolutionary Organization and the Idea for Autonomy for Macedonia and Adrianople Thrace, 1893-1912*, Budapest: Central European University – Department of History.

Vamvakovski, D. L. (2012) Greek-Macedonian Struggle: The Reasons for its Occurrence, *Macedonian Historical Review* 3, Skopje: University of Ss. Cyril and Methodius - Faculty of Philosophy.

Xhemaili, V. (2012) *Shqiptarët e Maqedonisë së sotme: nga Kryengritja e Dervish Carës 1834 deri te Kryengritja e Dibrës 1913*, Tetovë: Tringa Design.

Yosmaoğlu, İ. (2014). *Blood Ties: Religion, Violence, and the Politics of Nationhood in Ottoman Macedonia, 1878–1908*.

Атанасоски, Б. (2022) *Историскиот македонизам е лага во која пропаѓа нашата иднина!*, Слободен Печат, <https://www.slobodenpecat.mk/istoriskiot-makedonizam-e-laga-vo-koja-propagja-nashata-idnina/>

Габер, В. (2017) *Од објект до субјект: Македонија во меѓународните односи*, Скопје: Фондација "Фридрих Еберт", Канцеларија во Македонија.

Минов, Н. (2017). Зошто и како беа интернирани крушевските Власи за време на Првата светска војна?, *100 години од прогласувањето на влашкиот принципат Пинд и 100 години од интернирањето на Власите*, Скопје: Integra Nau.

Мојаноски, Ц.Т. (2002) *Основи на Општественото Уредување (Основи на политичкиот систем)*, Штип: Педагошки факултет „Гоце Делчев“.

Прошение на българите от Биголския вилает до Европейската комисија в Цариград с искания за реформи, *Сборник от документи и материали* (1978), София: Българска академия на науките.

Фрчковски, Љ.Д. (2023) *Белешки за македонскиот конституционализам: концепт на Уставот од 1991*, Скопје: Цивил - Центар за слобода.

Цацков, О. & Илиева Николова, А. (2022) *Балканските Војни и Првата Светска Војна*, Штип: Универзитет „Гоце Делчев“.